



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4844 prot.

Shkodër, më 02.03. 2026

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 27.02.2026**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 18, DATË 20.07.2023,  
“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/PËRDORIM TË SIPËRFAQES 0.3201 HA NË  
EKONOMINË PYJORE ‘PRUEMOS-SHELDI’, NGA STRA NR. 104, NJ.A. GURI I ZI, FSHATI  
SHELDI, PËR AKTIVITETIN E INSTALIMIT TË SHTYLLËS ERËMATESE PËR STUDIMIN  
E ERËS (AEROGJENERATORË), PËR NJË PERIUDHË 12-MUJORE, PËR SHOQËRINË  
‘VOLTALIA ALBANIE’”, TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.02.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, në mbështetje të nenit 27, pika 5, dhe nenit 54, shkronja “e/1”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016, të Ministrit të Mjedisit, “Për rregullat, procedurat e kërkimit, shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive”, i ndryshuar; si dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin në Vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 18, datë 20.07.2023, të ndryshuar, si më poshtë:  
Në paragrafin e fundit të pikës 1 ndryshohet afati nga “për një periudhë 24 muaj” në “për një periudhë 36 muaj”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 40 vota

|               |    |
|---------------|----|
| Vota Pro      | 40 |
| Vota Kundër   | 0  |
| Vota Abstenim | 0  |

Zbardhur me datë 02.03.2026

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

**KRYETAR**  
**Oltion LULI**